

VENDIM
I ASAMBLESË SË PËRGJITSHME
TË SHOQËRISË
"FRIGORIFERI DVORAN KORÇË" SH.A.
Nr.

Sot, më datë 04.02.2013, në selinë e shoqërisë "Frigoriferi Dvoran Korçë" sh.a., me adresë: Dvoran, Korçë, Shqipëri, u zhvillua Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Frigoriferi Dvoran Korçë" sh.a.

Mbledhja u thirr rregullisht nga Administratori i shoqërisë **Z. Fatjon Xhaferaj**, shtetas shqiptar, lindur më 08.02.1973, në Vlorë, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. 026564357, në cilësinë e Kryetarit të Mbledhjes.

Në mbledhje morën pjesë Aksionarët:


Z. Sokol Meqemeja, shtetas shqiptar, lindur më 28.06.1969, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. 029875010, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili zotëron 24,811 aksione, që përfaqësojnë 51,523 % të kapitalit themeltar të shoqërisë,

RENDI I DITËS:

1. Diskutimi dhe miratimi i ndryshimeve të Statutit të shoqërisë, të hartuara në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
2. Zgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve të Këshillit Administrativ të shoqërisë.
3. Depozitimim e këtij Vendimi dhe të Statutit të Ri të ndryshuar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Pasi u diskutuan të gjitha pikat e rendit të ditës, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të Shoqërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet e Statutit të shoqërisë "Frigoriferi Dvoran Korçë" sh.a.
 2. Të emërojë për një periudhë 3 vjeçare, nga data 04.02.2013 deri më datë 04.02.2016, në cilësinë e Anëtarit të Këshillit Administrativ, **Z. Sokol Meqemeja**, shtetas shqiptar, lindur më 28.06.1969, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. 029875010, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
 3. Të emërojë për një periudhë 3 vjeçare, nga data 04.02.2013 deri më datë 04.02.2016, në cilësinë e Anëtarit të Këshillit Administrativ, **Z. Memo Memaj**, shtetas shqiptar, lindur më 30.12.1951, në Vlorë, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. 026764850, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- 

4. Të emërojë për një periudhë 3 vjeçare, nga data 04.02.2013 deri më datë 04.02.2016, në cilësinë e Anëtarit të Këshillit Administrativ, **Zj. Marsela Kokoshi**, shtetase shqiptare, lindur më 15.01.1977, në Berat, banuese në Tiranë, mbajtëse e Kartës së Identitetit me Nr. 024746652, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
5. Të depozitohet Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme dhe Statuti i Ri i ndryshuar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Pasi u diskutuan në mënyrë të hollësishme të gjitha pikat e rendit të ditës dhe u morën vendimet përkatëse, Kryetari i mbledhjes e deklaroi atë të mbyllur, pasi nuk u sugjeruan më pika të tjera për diskutim.

AKSIONARËT:

Z. SOKOL MEQEMEJA



Sokol Meqeje

STATUTI

I

SHOQËRISË AKSIONARE

“FRIGORIFERI DVORAN KORCË” SHA



STATUTI

I

SHOQËRISË AKSIONARE

"FRIGORIFERI DVORAN KORÇË" SHA

KREU I

EMËRTIMI, VEPRIMTARIA, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1

Emërtimi i shoqërisë

- 1.1 Emri i shoqërisë është **"Frigoriferi Dvoran Korçë" sha**. Emri i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët "Shoqëri Aksionare" ose shkurtimi "SHA".

Neni 2

Forma e Shoqërisë

- 2.1 Shoqëria tregtare "Frigoriferi Dvoran Korçë" sh.a., është e organizuar si shoqëri aksionare me ofertë private. Shoqëria aksionare "Frigoriferi Dvoran Korçë" sh.a është formuar me Aktin e Themelimit datë 17.10.1995, dhe është regjistruar si person juridik me Vendimin Nr. Akt. 12660, datë 31.10.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.
- 2.2 Ky Statut hartohet në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (referuar në këtë statut si "*Ligji*"), Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore shqiptare në fuqi.

Neni 3

Selia e shoqërisë

- 3.1 Selia kryesore e shoqërisë është në adresën: Korçë, Dvoran, Mollaj. Ajo mund të ndryshojë dhe të transferohet në çdo vend tjetër me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 4

Objekti i shoqërisë

- 4.1 Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë është:
- a) Ruajtja dhe përpunimi me fason;



- b) Import-eksport me shumicë dhe pakicë;
 - c) Parking;
 - d) Dhoma, ambiente me qira.
- 4.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshojë ose të shtohet me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 5 Kohëzgjatja e shoqërisë

- 5.1 Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar. Ajo mund të përfundojë veprimtarinë në rastet e prishjes, falimentimit, ose likuidimit të shoqërisë, me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme, të parashikuara këto në legjislacionin shqiptar në fuqi.

KREU I DYTE

AKSIONET DHE AKSIONARËT

Neni 6 Kapitali themeltar (regjistruar) i shoqërisë

- 6.1 Kapitali themeltar (i regjistruar) i shoqërisë është 48, 155, 600 Lekë (dyzetë e tetë milion e njëqind e pesëdhjetë e pesë e gjashtëqind lekë).
- 6.2 Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 48, 155 (dyzet e tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e pesë) aksione me vlerë nominale 1, 000 (njëmijë) lekë secili.
- 6.3 Kapitali i shoqërisë zotërohet nga aksionarët e saj, të cilët janë si më poshtë vijon:
- i. **SOKOL MEQEMEJA**, zotërues i 24,811 (njëzet e katër mijë e tetëqind e njëmbëdhjetë) aksioneve që përbëjnë 51,52 % (pesëdhjetë e një presje pesëdhjetë e dy përqind) të kapitalit të shoqërisë,
 - ii. **MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS** (Shteti), zotërues i 9,150 aksioneve (nëntëmijë e njëqind e pesëdhjetë) që përbëjnë 19,00 % (nëntëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë,
 - iii. **THOMAS CHRISOGLOU**, zotërues i 12,973 aksioneve (dymbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre) që përbëjnë 26,94 % (njëzet e gjashtë presje nëntëdhjetë e katër përqind) të kapitalit të shoqërisë,
 - iv. **ENVER BAÇELLI**, zotërues i 13 (trembëdhjetë) aksioneve që përbëjnë 0,03 % (zero presje zero tre përqind) të kapitalit të shoqërisë ,
 - v. **PANDI JORGJI**, zotërues i 49 (dyzet e nëntë) aksioneve që përbëjnë 0,10 % (zero presje dhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë ,
 - vi. **JORGO CACA**, zotërues i 19 (nëntëmbëdhjetë) aksioneve që përbëjnë 0,04 % (zero presje zero katër përqind) të kapitalit të shoqërisë,



- vii. **TRASHËGIMTARËT (SULEJMAN) MBORJA**, zotërues të 221 (dyqind e njëzet e një) aksioneve që përbëjnë 0,46 % (zero presje dyzet e gjashtë përqind) të kapitalit të shoqërisë,
- viii. **KOÇO ÇEZMAXHI**, zotërues i 55 (pesëdhjetë e pesë) aksioneve që përbëjnë 0,11 % (zero presje njëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë,
- ix. **THANAS CECI**, zotërues i 19 (nëntëmbëdhjetë) aksioneve që përbëjnë 0,04 % (zero presje zero katër përqind) të kapitalit të shoqërisë,
- x. **ARBEN KODRA**, zotërues i 64 (gjashtëdhjetë e katër) aksioneve që përbëjnë 0,13 % (zero presje trembëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë,
- xi. **VASIL KALLÇO**, zotërues i 23 (njëzet e tre) aksioneve që përbëjnë 0,05 % (zero presje zero pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë,
- xii. **MARIA EMANOIL (ZIKO)**, zotëruese e 49 (dyzet e nëntë) aksioneve që përbëjnë 0,10% (zero presje dhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë,
- xiii. **TRASHËGIMTARËT MYFTIU**, zotërues të 221 (dyqind e njëzet e një) aksioneve që përbëjnë 0,46 % (zero presje dyzet e gjashtë përqind) të kapitalit të shoqërisë,
- xiv. **TRASHËGIMTARËT (BEHIJE) MBORJA**, zotërues të 184 (njëqind e tetëdhjetë e katër) aksioneve që përbëjnë 0,38 % (zero presje tridhjetë e tetë përqind) të kapitalit të shoqërisë,
- xv. **GJERGJI PËRMETI**, zotërues i 49 (dyzet e nëntë) aksioneve që përbëjnë 0,10% (zero presje dhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë,
- xvi. **VASILLAQ RUSHA**, zotërues i 72 (shtatëdhjetë e dy) aksioneve që përbëjnë 0,15% (zero presje pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë,
- xvii. **TRASHËGIMTARËT (SALUSH) MBORJA**, zotërues të 147 (njëqind e dyzet e shtatë) aksioneve që përbëjnë 0,31% (zero presje tridhjetë e një përqind) të kapitalit të shoqërisë,
- xviii. **NIKOLLAQ KRESHPANJI**, zotërues i 26 (njëzet e gjashtë) aksioneve që përbëjnë 0,05% (zero presje zero pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë,

a)

Neni 7**Të drejtat dhe detyrat e aksionarëve**

- 7.1 Pronësia mbi aksionet e Shoqërisë përmban aderimin me të drejta të plota në statutin e Shoqërisë nëpërmjet përfaqësimit në Asamblenë e Përgjithshme.
- 7.3 Cdo aksionar i shoqërisë ka të drejtën për të përfituar nga fitimet e shpërndashme të shoqërisë në përputhje me aksionet e tij, sipas vlerës nominale të zotëruar prej tij në kapitalin e shoqërisë.
- 7.4 Cdo aksionar ka të drejtë të marrë, kur është rasti, një tepricë nga likujdimi i kapitalit në përpjesëtim me vlerën e aksioneve që zotëron.



- 7.5 Aksionarët kanë të drejtën e votës dhe të përfaqësimit në Asamblenë e Përgjithshme sipas kushteve të parashikuara në këtë statut. Votat që zotërojnë aksionarët janë propocionale me përqindjet e aksioneve që zotërojnë.

Neni 8

Llojet, format dhe numri i aksioneve

- 8.1 Aksionet janë të formës emërore (nominative).
- 8.2 Në përputhje me dispozitat e ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga aksionet ekzistuese, aksionet e reja mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave të aksionarëve, sipas parashikimeve të nenit 145, pika 2 të ligjit.
- 8.3 Pronësia e aksioneve rezulton nga regjistrimi i tyre në emër të titullarëve në regjistrin e aksioneve të mbajtur nga ana e shoqërisë dhe nga ndërmjetësit financiarë.
- 8.4 Regjistri i aksioneve të shoqërisë do të përmbajë të dhëna të zotëruesve të aksioneve të shoqërisë, si: emrin e mbiemrin e aksionarit, apo emri i regjistruar, nëse është person juridik, vlera nominale e aksionit, adresa e banimit apo zyra qendrore e aksionarit dhe data e kryerjes së regjistrimit.
- 8.5 Secili aksionar ka të drejtë të kërkojë me shkrim dhe të marrë një certifikatë për të gjitha aksionet e çdo klase të zotëruara nga ai, kundrejt një shumë të paguar që do të përcaktohet me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë. Dorëzimi i certifikatës përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të aksioneve do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë këtyre zotëruesve të përbashkët.

Neni 9

Shitja dhe transferimi i aksioneve

- 9.1 Aksionet e shoqërisë dhe të drejtat, që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen vetëm me akt noterial, nëpërmjet:
- a) shitblerjes;
 - b) trashëgimisë;
 - c) dhurimit,
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 9.2 Aksionet e shoqërisë janë lirisht të transferueshme ndërmjet aksionarëve.
- 9.3 Aksionet e shoqërisë janë të transferueshme (shiten) tek të tretët (që nuk janë aksionarë të shoqërisë), vetëm me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme, pasi të jetë ushtruar e drejta e parablerjes nga aksionarët, sipas ligjit.

Neni 10

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 10.1 Kapitali themeltar mund të ndryshohet me të gjitha mënyrat dhe modalitetet që kërkon dhe lejon ligji për këtë qëllim.

KREU III

ORGANET E SHOQËRISË. TË DREJTAT DHE DETYRIMET. MBLEDHJET. VOTIMI

Neni 11 Organet e shoqërisë

- 11.1 Organet e shoqërisë janë:
- a) Asambleja e Përgjithshme,
 - b) Këshilli i Administrimit,
 - c) Administratori.

Neni 12 Asambleja e Përgjithshme. Të drejtat dhe Detyrimet

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme është organi që ushtron funksione administrimi, mbikëqyrjeje dhe vendimarrjeje lidhur me veprimtarinë e shoqërisë.
- 12.2 Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshime të statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit,
 - ç) emërimin dhe revokimin e administratorëve;
 - d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - dh) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c", "ç" dhe "d" të kësaj pike;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ç) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
 - f) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
 - g) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
 - gj) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
 - h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
 - i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
 - k) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

Neni 13 Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme. Rendi i ditës

- 13.1 Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimit të botuar në një gazetë të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin. Njoftimi, së bashku me rendin e ditës duhet të botohet jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.
- 13.2 Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën dy herë në vit nga Administratori, anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe Aksionarët e shoqërisë të cilët përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

- 13.3 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret për të marrë vendime lidhur me rastet e parashikuara në Nenin 12, pika 2 të këtij statuti, si dhe në raste të tjera të parashikuara në ligj.
- 13.4 Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas formaliteteve të këtij Statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë aksionarët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 14 **Përfaqësimi në Asamblenë e Përgjithshme**

- 14.1 Një aksionar mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një aksionar tjetër apo nga një person i tretë, i cili duhet të jetë hartuar sipas Modelit të mëposhtëm:
- "Unë/Ne i/të nënshkruari/t,, në cilësinë e aksionarit/aksionarëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/më) Z./Zj., ose në pamundësi të tij/saj, Z./Zj....., në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më datë*
- Nënshkruar më.....".*
- 14.2 Administratorët dhe anëtarët e Këshillit të Administrimit nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në Asamblenë e Përgjithshme.
- 14.3 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 14.4 Një kopje e Autorizimit depozitohet në zyrën qendrore të shoqërisë ose në një vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

Neni 15 **E drejta e votës**

- 15.1 Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga aksionet, çdo aksion i jep aksionarit (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose aksionarit (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote, në raport proporcional me pjesën e kapitalit që përfaqëson aksioni.
- 15.2 Asnjë aksionar nuk voton në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme apo në mbledhjet e veçanta të zotëruesve të aksioneve të klasave të ndryshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me aksionet e zotëruara prej tij, nëse nuk ka

shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këto aksione dhe në rast se kanë votuar, votat e tyre do të konsiderohen të pavlefshme.

Neni 16

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme. Kuorumi. Marrja e Vendimeve

- 16.1 Asambleja e Përgjithshme, në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë aksionarët (ose përfaqësuesit e tyre), që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të aksioneve, me të drejtë vote.
- 16.2 Asambleja e Përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave të aksionarëve që marrin pjesë në votim, në lidhje me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 16.3 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, për të cilat kërkohet një shumicë e kualifikuar, sipas përcaktimit të nenit 16, pika 2, të këtij Statuti, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm në mbledhje aksionarët (ose përfaqësuesit e tyre) që zotërojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të aksioneve, me të drejtë vote.
- 16.4 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në nenin 16, pikat 1 dhe 3 të këtij Statuti, Asambleja do të mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
- 16.5 Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme caktojnë Kryetarin e mbledhjes si edhe një person për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes.
- 16.6 Një anëtar i Këshillit të Administrimit, pavarësisht se nuk është aksionar, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, por pa të drejtë vote.
- 16.7 Kryetari, me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në pajtim me kuorumin e caktuar nga ligji, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën 7 ditë të plota përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.
- 16.8 Asambleja e Përgjithshme vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet një votim i fshehtë. Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit ose të administratorit, Asambleja e Përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionarët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 përqind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, ose përfaqësuesi i autorizuar.

- 16.9 Me përjashtim të kundërshtimit të një aksionari, deklarimi i Kryetarit se vendimi është marrë në mënyrë unanime, ose me një shumicë të caktuar, nuk është miratuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi përkatës në procesverbalin e mbledhjes, përbën provë përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.
- 16.10 Në rast se ka kundërshtime për deklaratën e parashikuar në pikën 9 të këtij neni, do të zhvillohet një numërim i hapur për përcaktimin e numrit të votave pro dhe kundër vendimit.
- 16.11 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme. Procesverbali nënshkruhet nga Kryetari dhe mbajtësi i procesverbalit.

KREU IV

KËSHILLI I ADMINISTRIMIT. ADMINISTRATORI

Neni 17

Të drejtat dhe detyrat e Këshillit të Administrimit

- 17.1 Këshilli i Administrimit të Shoqërisë ka këto të drejta dhe detyrime:
- a) të japë direktiva për administratorin për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratori;
 - c) të përgatisë, me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e Asamblesë së Përgjithshme;
 - ç) të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
 - d) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
 - dh) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
 - e) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratori. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit për t'iu paraqitur Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me një raport të Këshillit të Administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
 - ë) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar Asamblesë së Përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit e administratorit. Raporti i këshillit të administrimit, përmendur në shkronjën "e" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;
 - f) të emërojë dhe të shkarkojë administratorin;
 - g) të përcaktojë shpërblimin e administratorit;
 - gj) të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;

- k) të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;
 - i) të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 17.2 Këshilli i Administrimit udhëzon Administratorin në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe kontrollon përputhshmërinë e tyre me ligjin dhe Statutin. Detyrat e Këshillit të Administrimit, sipas shkronjave "b", "c", "ç", "d", "dh", "e", "ë", "f", "g", dhe "i" të pikës 1 të këtij neni dhe pikës 2 të nenit 154 të Ligjit, nuk mund ti delegohen Administratorit.

Neni 18

Përbërja e Këshillit të Administrimit. Emërimi dhe Shkarkimi i anëtarëve të tij

- 18.1 Këshilli i Administrimit të shoqërisë do të përbëhet nga 3 anëtarë, si më poshtë vijon:
- a) Z. Sokol Meqemeja, anëtar dhe Kryetar i Këshillit të Administrimit, i cili emërohet për një periudhë 3-vjecare, nga data 04.02.2013 deri më datë 04.02.2016,
 - b) Zj. Marsela Kokoshi, anëtare dhe Nënkyetare e Këshillit të Administrimit, e cila emërohet për një periudhë 3-vjecare, nga data 04.02.2013 deri më datë 04.02.2016,
 - c) Z. Memo Memaj, anëtar i Këshillit të Administrimit, i cili emërohet për një periudhë 3-vjecare, nga data 04.02.2013 deri më datë 04.02.2016.
- 18.2 Anëtarët e Këshillit të Administrimit duhet të jenë të pavarur dhe nuk do të jenë administratorë.
- 18.3 Anëtarët e këshillit të administrimit zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e e votave të aksionarëve që marrin pjesë, për një periudhë deri në 3 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.
- 18.4 Këshilli i administrimit duhet të zgjedhë kryetarin dhe nënkryetarin e tij, të cilët nuk duhet të jenë administratorë.
- 18.5 Zhvillimi i mbledhjeve të këshillit të administrimit regjistrohet në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga kryetari. Parregullsitë për mbajtjen e procesverbalit nuk kanë si pasojë pavlefshmërinë e vendimeve të marra.
- 18.6 Detyra e anëtarit të Këshillit të Administrimit përfundon në rast se:
- a) Ka mbaruar afati për të cilin është emëruar dhe nuk rizgjidhet;
 - b) Personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar paraprakisht shoqërinë.
 - c) Ka munguar për më shumë se 12 muaj radhazi pa lejen e anëtarëve të tjerë të Këshillit të Administrimit në mbledhjet e këtij këshilli të mbajtura gjatë kësaj periudhe.
- 18.7 Asambleja e Përgjithshme për raste të parashikuara nga ky statut dhe ligji mund të shkarkojë, në çdo kohë, një anëtar të këshillit të administrimit, me shumicë të thjeshtë votash.



Neni 19
Mbledhjet e Këshillit të Administrimit

- 19.1 Mbledhjet e Këshillit të Administrimit do të mbahen të paktën dy herë në vit sipas nevojave të aktivitetit tregtar të Shoqërisë, derisa Asambleja e Përgjithshme të vendosë me shumicë të zakonshme votash mbi shpeshtësinë e mbledhjeve të Këshillit të Administrimit.
- 19.2 Vendimet e Këshillit të Administrimit vlerësohen të vlefshme, nëse në procesin e vendimmarrjeve janë të pranishëm më shumë se një e dyta e anëtarëve. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.
- 19.3 Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit që kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjen e Këshillit të Administrimit do të konsiderohet si i vlefshëm dhe i efektshëm njëloj si të ishte miratuar në mbledhjen e Këshillit të Administrimit, të thirrur dhe mbledhur rregullisht.

Neni 20
Administratori. Të drejtat dhe detyrimet. Emërimi dhe Shkarkimi i tij

- 20.1 Këshilli i Administrimit zgjedh me shumicë të thjeshtë votash një person fizik si Administrator dhe përfaqësues ligjor të Shoqërisë për një periudhë deri në 3 vite, me të drejtë rizgjedhjeje.
- 20.2 Administrator i shoqërisë zgjidhet Z. Fatjon Xhaferaj, për një periudhë 3-vjeçare, nga data 04.02.2013 deri më 04.02.2016.
- 20.3 Administratori ka të drejtë dhe detyrohet:
- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
 - b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, që ia paraqesin këshillit të administrimit për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme;
 - d) të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;
 - e) të raportojë përpara këshillit të administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;
 - ë) të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 20.4 Administratori mund të shkarkohet në çdo kohë me shumicë të thjeshtë votash nga Këshilli i Administrimit.

Neni 21



Emërimi i ekspertëve kontabël të autorizuar

- 21.1 Me propozim të Këshillit të Administrimit, Asambleja e Përgjithshme cakton një ose më shumë persona fizikë ose një shoqëri ekspertësh kontabël të autorizuar si ekspertë kontabël të autorizuar të shoqërisë për një periudhë 3-vjecare me radhë, në pajtim me shkronjën "d", pika 2, të nenit 12 të këtij Statuti . Emërimi bëhet nëpërmjet një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të zakonshme, i cili nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si ekspert kontabël të autorizuar të Shoqërisë.
- 21.2 Gjatë mandatit të tyre, ekspertët kontabël të autorizuar mund të largohen nga detyra me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të zakonshme.
- 21.3 Eksperti Kontabël i Autorizuar ose shoqëria e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar i raporton Këshillit të Administrimit, për çështjet kryesore që rezultojnë nga kontrolli financiar dhe, në veçanti, për dobësi të kontrollit të brendshëm në lidhje me procesin e raportimit financiar.

Neni 22

Hetimet e Posaçme dhe Mbikëqyrja

- 22.1 Çdo person ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin ose zëvendësimin e një eksperti të posaçëm në bazë të nenit 150 të Ligjit ose për të kërkuar nga Këshilli i Administrimit që të kryejë detyrat e mbikëqyrjes në rastet e veçanta të parashikuara nga neni 165 i Ligjit, depozitojnë në selinë e shoqërisë dokumentin e noterizuar i cili vërteton se ky/këta person/a plotësojnë kushtet për të kryer këtë veprim

Neni 23

Shpërblimi dhe kostot e anëtarëve të Këshillit të Administrimit

- 23.1 Anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe Administratorët do të kenë të drejtë të shpërblehen në bazë të skemës së vendosur nga Këshilli i Administrimit dhe të miratuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me parashikimet e këtij Statuti dhe pikën 1, neni 160 të Ligjit.

Neni 24

Kufizimet në Votime

- 24.1 Anëtarët e Këshillit të Administrimit nuk do të lidhin marrëveshje ose votojnë në mbledhjen e Këshillit të Administrimit mbi çështje në të cilin këta anëtarë kanë, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është ose mund të jetë në kundërshtim me interesat e Shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit, deri në momentin kur në mbledhjen e Këshillit të Administrimit, të gjithë anëtarët kanë rënë dakord që:
- a) Të autorizojnë lidhjen e kësaj marrëveshje; dhe

- b) Të autorizojnë këtë anëtar që të votojë në lidhje me këtë çështje.
- c) Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Në këtë rast zbatohet parashikimi i pikës 2 dhe 5 të nenit 13 të Ligjit.
- d) Vota e anëtarit të Këshillit të Administrimit nuk do të llogaritet në kuorumin e pjesëmarrësve në mbledhje në lidhje me vendimin për të cilin ky anëtar nuk ka të drejtë të votojë.
- e) Në rast se në mbledhjen e Këshillit të Administrimit diskutohet një çështje e lidhur me të drejtën e votës së një anëtarit të tij, çështja, përpara përfundimit të mbledhjes, mund ti drejtohet Kryetarit të mbledhjes dhe vendimi i tij lidhur me çdo anëtar të Këshillit të Administrimit të ndryshëm nga ai vetë do të jetë përfundimtar.

KREU V

DIVIDENDËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR

Neni 25

Dividendët

- 25.1 Në përputhje me dispozitat e Ligjit, shoqëria me shumicë të zakonshme të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë dividendët në përputhje me të drejtat përkatëse të aksionarëve.
- 25.2 Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një aksion nuk prodhon interesa kundrejt shoqërisë nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat e aksionit.
- 25.3 Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset nga Këshilli i Administrimit, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

Neni 26

Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

- 26.1 Këshilli i Administrimit, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë votash sipas kuorunit të përcaktuar nga neni 145 i Ligjit, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të Shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezerva ligjore ose kapitali.

KREU VI

PRISHJA E SHOQËRISË. NJOFTIMET

Neni 27

Prishja e shoqërisë dhe likuidimi



- 27.1 Shoqëria aksionare prishet:
- a) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
 - b) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë;
 - ç) me vendim gjykate.
- 27.2 Në rast prishjeje shoqëria duhet të likuidohet.
- 27.3 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithëshme emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raporte përfundimtare mbi gjendjen e Aktivit dhe Pasivit të shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 27.4 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesit dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 27.5 Pas pagimit të detyrimeve të shoqërisë dhe mbledhjes së kreditorëve, likuidatori do të kalojë të ardhurat përfundimtare të likuidimit për aksionarët.
- 27.6 Likuidatori/ët njoftojnë Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e procesit të likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë në përputhje me parashikimet e ligjit "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 28

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 28.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 28.2 Në rast se zgjidhja e mosmarrëveshjeve nuk arrihet me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Neni 29

Njoftimet

- 29.1 Çdo njoftim që u jepet ose kryhet nga persona, duhet të bëhet me shkrim dhe të drejtohet në adresën respektive, sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Statut.
- 29.2 Shoqëria mund t'i japë njoftim një aksionari, personalisht ose duke e dërguar me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të aksionarit e cila i është njoftuar



Shoqërisë nga aksionari. Kur ka disa bashkëzotërues të një aksioni, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në pajtim me pikën 1 të nenit 121 të Ligjit.

Neni 30
Dispozita Përfundimtare

- 30.1 Çështjet që nuk janë trajtuar në këtë Statut, rregullohen sipas legjislacionit përkatës të Republikës së Shqipërisë.
- 30.2 Ky Statut u hartua në 6 gjashtë kopje të njëjta origjinale në gjuhën shqipe.

Miratuar në mbledhjen e përgjithshme të Asamblesë së Përgjithshme të mbajtur më datë 04.02.2013.

AKSIONARËT:

SOKOL MEQEMEJA:

